



REPUBLIKA E KOSOVES  
KOMUNA LIPJAN  
REPUBLIKA KOSOVO  
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: Primijeno:	11.05. 20 22	
Njësia Jednicë	Numri Broj	Shtojca Dodatak
1-453/01-	23734	

PROJECT: "Further stabilisation of Kosovo minority and majority communities in Kosovo through enhanced socio – economic support"  
Office: Yusuf Ozer 3 | 20000 Prizren – Kosovo | Phone: +383 29 210 070 | e mail: info@socio-project.net

## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

Projekti: " Stabilizimi i mëtejshëm i komuniteteve pakicë dhe shumicë në Kosovë  
përmes mbështetjes së shtuar socio-ekonomike "

i përfaqësuar nga  
**Fondacioni për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik - PREDA Plus**  
**dhe**  
**WEntrepreneur**

dhe

**Komuna Lipjan**

Lipjan, Maj 2022

1/4

Implemented by:

## Hyrje

"Stabilizimi i mëtejshëm i komuniteteve pakicë dhe shumicë në Kosovë përmes mbështetjes së shtuar socio-ekonomike" i njohur gjithashtu si "Socio - Projekti 2", është iniciativë e financuar nga Engagement Global, në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim - BMZ dhe është duke u implementuar nga Fondacioni për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik - PREDA Plus Kosova në partneritet me WEntrepreneur Kosovë dhe me mbështetjen e Arbeiter Samariter Bund - ASB, Këln, Gjermani. Projekti ka filluar zyrtarisht më 1 Nëntor 2020 dhe do të zbatohet deri më 31 Dhjetor 2022.

Projekti synon të vazhdojë të krijojë jetesë të qëndrueshme dhe kushte më të mira socio-ekonomike për familjet etnike pakicë dhe shumicë në Kosovë përmes sigurimit të gjenerimit të të ardhurave, ndërtimit të kapaciteteve, punësimit dhe mundësive të zhvillimit të komunitetit.

### Neni 1. Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi për Bashkëpunim (MB) është të sigurojë një kornizë për bashkëpunimin e ardhshëm ndërmjet palëve, duke përkrahur përgjegjësitë dhe angazhimin e ndërsjellë për të mirën e një zbatimi të suksesshëm të Projektit.

### Neni 2. Fushat e Bashkëpunimit

Projekti: "Stabilizimi i mëtejshëm i komuniteteve pakicë dhe shumicë në Kosovë përmes mbështetjes së shtuar socio-ekonomike" do t'i përgjigjet nevojave të komuniteteve pakicë dhe shumicë në Kosovë në koordinim të ngushtë me Komunën e Lipjanit.

Fushat e bashkëpunimit përshkruhen përmes Komponentëve të Projektit të cilat parashikohen të zbatohen sipas kësaj nisme:

Mbështetja e themelimit të bizneseve fillestare – 7 biznese fillestare nga Komuna e Lipjanit që promovojnë ide krijuese: do të jenë biznese të sapo regjistruara që kanë ide krijuese për produkte dhe shërbime, të cilat aktualisht janë të kufizuara ose inekzistente në tregjet lokale. 7 Biznese fillestare të tilla do të mbështeten përmes një Skeme specifike të Granteve, para se gjithash kanë qenë të nënshtruar trajnimit të detyrueshëm, në mënyrë që të konkurrojnë për këto grante. Secila nga 7 bizneset fillestare nga Komuna e Lipjanit kanë aplikuar përmes një procesi të Skemës së Granteve "Gratë në Biznes" me Nr.Reference KOS2002 – A1 dhe janë nënshtruar procesit të vlerësimit. Këto biznese do të duhet gjithsecili të punësojnë, së paku nga një (1) person.

### Neni 3. Kushtet e financimit

Në këtë fazë të Projektit 7 biznese fillestare nga Komuna e Lipjanit janë përzgjedhur dhe do të financohen së bashku nga Socio - Projekti 2 dhe Komuna e Lipjanit në total prej 17,500.00 euro.

Pas vlerësimit të aplikimeve, Komisioni i Vlerësimit identifikoi përfituesit e mëposhtëm për t'u ndarë fonde:

Nr.	Emri & Mbiemri i Përfitueses	Numri personal	Adresa
1	Florije Jahiri	1015573267	Rr. Haxhi Kleqka, Lipjan
2	Fatime Sinani	1244089204	Rr. Rruga e naltë, Grackë e vjetër, Lipjan
3	Samire Krasniqi Selimi	1175649430	Rr. Hysen Tmava 2, Fshati Llugaxhi, Lipjan
4	Adelina Zeneli	1232503960	Rr. Tahir Sinani pn, Lipjan
5	Behare Gashi Zeneli	1172924677	Lagjia e Burimit pn, Lipjan
6	Enesa Flugaj Azemi	1172922305	Rr. Kongresi i Blinajës 43, Lipjan
7	Qendresa Zeqiri	1234066818	Fshati Topliqan, Lipjan

#### Neni 4. Përgjegjësitë e Palëve

- 4.1. Në përputhje me rezultatet e pritshme të përshkruara në Nenin 2, Socio – Projekti 2 do të sigurojë një zbatim të suksesshëm të të gjitha aktiviteteve duke:
  - Ofruar Ndhimën Profesionale për bizneset përfituese nga projekti.
  - Siguruar aftësimin e personave/përfituesve të Projektit, të cilat do të rriten në një nivel të kënaqshëm.
  - Për të zhvilluar me procedim publik tenderues për pajisjet e kërkuara nga ana e bizneseve përfituese.
  - Shpërndarjen e këtyre mjeteve si dhe monitorimin.
- 4.2. Vlera e participimit të Socio – Projektit 2 si pjesë e bashkëfinancimit do të jetë 81.32% të vlerës totale apo 14,231.00 euro.
- 4.3. Komuna e Lipjanit do të sigurojë ekzistencën e një niveli dhe cilësie të mjaftueshme e informacioneve që do t'i ofrohen Palëve, për nevojat e zbatimit të aktiviteteve të Projektit. Në raste kur paraqitet nevoja, Komuna do të ofrojë personelin e saj në mënyrë që të ndihmojnë në zbatim të suksesshëm të aktiviteteve të Projektit.
- 4.4. Vlera e participimit të Komunës së Lipjanit si pjesë e bashkëfinancimit do të jetë 9.34% të vlerës totale apo 1,634.50 euro.

- 4.5. Të gjitha bizneset e reja do të sigurojnë 9.34% të fondeve në formë bashkëfinancimi. Shuma totale që përfituesit do të bashkëfinancojnë është 1,634.50 euro, ndërsa çdo bashkëfinancim individual do të jetë në vlerë 233.50 euro.
- 4.6. Të gjitha aktivitetet për realizimin e "Socio Projekti 2" do të zbatohen dhe monitorohet nga ana e PREDA Plus në partneritet me WEntrepreneur Kosovë dhe me mbështetjen e Arbeiter Samariter Bund - ASB, Këln, Gjermani.

#### Neni 5. Hyrja në fuqi

Ky Memorandum hyn në fuqi, në datën e nënshkrimit dhe zgjat deri më 31. Dhjetor. 2022, datë kjo që përfaqëson edhe fundin e Projektit.

#### Neni 6. Përfundimi

Secila palë mund ta ndërpresë këtë bashkëpunim duke i dhënë palës tjetër, një njoftim tridhjetë (30) ditësh me shkrim. Në rast të ndërprerjes së pjesëshme, njoftimi i tillë do të përcaktojë se cilat fusha të ndihmës janë prekur.

#### Neni 7. Gjuha


Ky Memorandum është përgatitur në katër dokumente origjinale, dy në Gjuhën Shqipe dhe dy në Gjuhën Angleze. Palët do të marrin nga një dokument original në të dy Gjuhët.

#### Palët Nënshkruese:

##### Në emër të Autoritetit Zbatues:

Emri: Valentin Hoxha  
Titulli: Drejtor i Projektit

Nënshkrimi:



Datë:

11.05.2022



##### Në emër të Komunës Partnere

Emri: Imri Ahmeti  
Titulli: Kryetar  
Komuna: Lipjan

Nënshkrimi:



Datë:

11.05.2022

